

VENDIM
Nr. 40, datë 9.12.2015

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT MBËSHTETËS PËR MIRATIMIN E
TARIFAVE PËR SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË, LARGIMIN E PËRPUNIMIN E
UJËRAVE TË NDOTURA**

Në zbatim të nenit 14 dhe nenit 22, pika 1, të ligjit numër 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektori të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, dhe në plotësim të vendimit të KKRR-së nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Të miratojë dokumentacionin mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura, i detyrueshëm për t'u plotësuar nga të gjithë operatorët që ofrojnë këto shërbime, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë e pandarë e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Avni Dervishi

DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT

1. ERRU-ja, bazuar në kërkesat ligjore, si dhe për të pasur një vendimmarrje sa më të drejtë në lidhje me propozimin për nivelin e ri të tarifave për shërbimet që ofrojnë operatorët, përcakton dhe miraton një listë dokumentesh mbështetëse.

2. Propozimi për ndryshim tarife duhet të përfshijë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Bilanci dhe pasqyrat financiare të vitit të fundit të cilit i referohemi (në rast se nuk e kanë dorëzuar përpara aplikimit siç kërkohet nga ERRU-ja), si dhe raporti i ekspertit kontabël;
- Vendimi i organit drejtues për nivelin e ri të tarifave të kërkuar nga operatori;
- Mendimi i pronarit (njësia e qeverisjes vendore) për nivelin e ri të tarifave të kërkuar nga operatori;
- Procesverbali i seancave dëgjimore me publikun;
- Raport i detajuar për gjendjen teknike dhe ekonomike të operatorit;
- Justifikimi i nivelit të ri të tarifave dhe llogaritja e tyre bazuar në modelin e llogaritjes së tarifave miratuar nga ERRU-ja;
- Subvencionet¹, të cilat operatori do t'i marrë për periudhën gjatë së cilës do të aplikohen tarifat e propozuara;
- Vendimi i miratimit të Kodit të Ujit nga organi drejtues dhe operatori.

3. Mungesa e një prej dokumenteve të sipërpërmendura bën që propozimi për ndryshim tarife të mos shqyrtohet nga ERRU-ja.

4. Raporti i detajuar për gjendjen teknike dhe ekonomike i sipërpërmendur duhet të përmbajë:

a) Për sistemet e furnizimit me ujë:

- Një analizë të gjendjes aktuale të të gjitha elementeve përbërëse të tij (burimet e ujit/vepra e marrjes, stacionet e pompimit, rezervuarët e ujit, njësitë e dezinfektimit/pastrimit të ujit, linjat e dërgimit dhe rrjetet shpërndarëse).

- Informacion për problemet kryesore në lidhje me:

¹ Operatorët duhet të deklarojnë shumën e subvencioneve të marra në vitin e kaluar, si dhe shumën e parashikuar për t'u marrë gjatë vitit aktual nga buxheti i shtetit. ERRU-ja do të marrë në konsideratë gjatë procesit të miratimit të tarifave subvencionin e marrë, si dhe parashikimin e subvencionit për vitin e ardhshëm.

- operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit, humbjet e ujit, lidhjet e paligjshme, matjet;
- cilësinë e ujit të shërbyer;
- investimet e kryera në tri vitet e fundit ose që nga periudha e aprovimit të fundit të tarifave duke dhënë edhe objektet kryesore ku janë bërë këto investime, si dhe rezultatet që janë arritur në përmirësimin e shërbimit;
- strukturën organizative dhe numrin e punonjësve për këtë shërbim të shoqëruar edhe me shpjegimet përkatëse;
- zonën e shërbimit dhe popullsinë që banon në të, konsumatorëve që iu shërbehet bazuar në të dhënat e regjistrit të konsumatorit;
- plotësimin e kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 9.1.2008, “Për tarifat e përdorimit të ujit”;
- eficiencën e energjisë.
- Analizën e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera për periudhën aktuale dhe parashikimin e tyre për periudhën për të cilën kërkohet ndryshimi i tarifave.

b) Për sistemet e kanalizimeve:

- Një analizë të gjendjes aktuale të të gjitha elementeve përbërëse të tij (linjat e shkarkimit/grumbullimit të ujërave të ndotura, stacionet e pompimit, veprat e shkarkimit të ujërave të ndotura në trupat ujorë pritës, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura).
- Informacion për problemet kryesore në lidhje me:
- operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit;
- investimet e kryera në tri vitet e fundit ose që nga periudha e aprovimit të fundit të tarifave duke dhënë edhe objektet kryesore ku janë bërë këto investime, si dhe rezultatet që janë arritur në përmirësimin e shërbimit;
- strukturën organizative dhe numrin e punonjësve të këtij shërbimi të shoqëruar edhe me shpjegimet përkatëse;
- zonën e shërbimit dhe popullsinë që banon në të, konsumatorëve që iu shërbehet bazuar në të dhënat e regjistrit të konsumatorëve.
- Informacion i detajuar teknik në lidhje me impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura (nëse kanë) duke përfshirë të dhëna për procesin kapacitetin, eficiencën e energjisë.
- Analizën e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera për periudhën aktuale dhe parashikimin e tyre për periudhën për të cilën kërkohet ndryshimi i tarifave.

5. Për të analizuar dhe për të vlerësuar propozimin për ndryshimin e tarifave, të paraqitur nga operatorët, ERRU-ja mund të përdorë të dhëna zyrtare të grumbulluara nga institucione të tjera publike, si: Njësia e Monitorimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetës-Kanalizimeve, në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit; INSTAT-i; Instituti i Shëndetit Publik; laboratorët e shëndetit publik rajonal; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Mjedisit; Ministria e Financave etj. Këto të dhëna do të përdoren, gjithashtu, për të vlerësuar objektivat e performancës që u janë caktuar operatorëve nga ERRU-ja.

6. ERRU-ja, në bazë të ligjit nr. 8102 (i ndryshuar) mund të kryejë inspektime për të verifikuar të dhënat e paraqitura nga operatori.

7. Dokumentet tip janë një model i dokumenteve të kërkuara më sipër, përgatiten nga ERRU-ja dhe janë të aksesueshme në faqen zyrtare të internetit të ERRU-së.